

H Y L L I I D R I T Ë S

E PËRKOHSHME KULTURALE - LETRARE

Editorial	
A po vdesin shqiptarët si komb?	3
Kasem Biçoku	
Kisha e shën Trinisë e formulës së pagëzimit	6
Aleksandër Mexi	
Aspekte të historisë së Ileshkvisë së Sapës dhe lista e ipeshkvijve	37
Bardhyl Demiraj	
Johannes Brunius Olchini (†1571)	49
Lucia Nadin - Mario Bonaldi	
Il presbitero albanese Girolamo Messio, la chiesa di San Sebastiano a Venezia, le pitture di Paolo Veronese	63
Italo Sarro	
Il martirio dei francescani Salvatore da Offida e Paolo da Mantova nel 1644	90
Bardhyl Demiraj	
<Pun t'nevoiscime me u dytun per me Scelbue Scpjrtin ...> – Romae 1828, 1776 apo 1773 (?)	111
Kurt Gostentschnigg	
Shkolla e parë shqipe në Kosovë dhe politika arsimore e Austro-Hungarisë ndaj territoreve shqiptare	119
Bahri Beci	
Probleme të metodës së studimit të dukurive dialektore të shqipes	129

Pietro Di Marco Un monastero nella storia culturale <i>arbëreshe</i>	144
Injac Zamputti Pozita shoqnore e grues malësore shqiptare sipas Kanunit	166
Ervis Reçi Mustafa Kruja në përpjekjet për krijimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar	193
Arba Baxhaku Rreth rindërtimit të Kishës së Shën Mërisë së Vaut të Dejës përmes një rrëfimi lundruës mbi Drin	203
ARKIVI I HYLLIT	
Letërkëmbim ndërmjet Luigj Gurakuqit dhe Sotir Gjikës (1919-1921)	210
KRONIKË	
Kuvendi albanologjik “Shqipëria në Arkivin e Propagandës Fide” në Vatikan (26-27 tetor 2015)	249
NEKROLOGJI	
Hans-Jürgen Sasse (1943-2015)	254
Aleksandër Stipçeviq (1930-2015)	260

In memoriam
Hans-Jürgen Sasse
 (30.04.1943 – 14.01.2015)



Hans-Jürgen Sasse u largua prej nesh, pas një lëngate të gjatë, të rëndë e të pashërueshme; mbylli sytë për të fundit herë orët e mëngjesit të datës 14 janar 2015. Ndarja, sado e përkohshme qoftë, është gjithmonë e dhimbshme dhe brenga po aq e madhe, sidomos kur përjeton se si njeriu ynë largohet nga kjo botë dhe merr me vete një masë të tërë të atij kumti që donte ta linte mirëfilli në plotësinë e vet mes nesh, sikurse edhe ne duhej ta përcillnim mirëfilli si të tillë në vazhdimësi. Ndarje

dhe brengë bashkë... Sepse Hans-Jürgen Sasse iu gëzua vërtet shumë daljes së tij dikurshme në pension në vitin 2008, meqë kështu kishte për të pasur më shumë mot e mundësi me plotësuar e përfunduar atë kumt që kishte shestuar dikur në të ri të vet, qysh në vitet 60-të të shekullit të kaluar, kur rendte poshtë e lart nëpër ngulimet arvanitase të Greqisë, duke mbledhur material gjuhësor prej atyre varianteve arkaike të shqipes, të cilat jemi mësuar t'i lexojmë e citojmë – falë konceptionit të tij nismëtar!!! – me emërtimin e mirëfilltë edhe gjuhësor *arvanitishte* (= gr. /arvanitika/). Është ky një term përmbledhës që sendërton as më shumë e as më pak se varietetet e njërës prej pinjollëve të familjes së gjuhëve shqipe që gjëllin sot e gjithë ditën – sado gjithnjë nën rrezikun drejt shuarjes së natyrshme!!! – brenda dhe jashtë Gadishullit Ballkanik. Vetëm një pjesë e këtij mesazhi, më saktë një e katërta e tij na është përcjellë ndërkohë në të gjallë të vet, në rast se lejohemi t'i referohemi këtu projektit afatgjatë të studimeve solide të Hans-Jürgen Sasse-s mbi arvanitishten e Greqisë në plot katër vëllime, me titull kryesor *Arvanitika* e nëntitull *Die albanischen Sprachreste in Griechenland* (= Arvanitishtja. Mbetjet gjuhësore shqipe në Greqi).

Hans-Jürgen Sasse lindi më 30 prill të vitit 1943 në Berlin. Pas përfundimit të shkollës fillore në Berlin-Zehlendorf u regjistrua në vitin 1956 në gjimnazin klasik, të cilin e përfundoi me provimet e pjekurisë më 1962. Deri në vitin 1965 studioi për disa semestra në Universitetin

e Lirë (Freie Universität) të Berlinit në degët filologji klasike dhe gjuhësi, por duke u ndjerë i zhgënjyer ndaj nënvleftësimit zyrtar që i bëhej gjuhëve “të vogla” ndërron shpejt profil studimi, madje qysh në semestrin e tretë, duke u përqendruar në fushat e semitologjisë, ballkanologjisë, indoeuropianistikës dhe të gjuhësisë së përgjithshme.

Qëndrimi njëvjeçar në Selanik (1965/66), ku mori kontakt për të parën herë me të folmet arvanitase, përcaktoi edhe fatin e angazhimit të tij jetësor në njohjen dhe studimin e këtyre të folmeve. Ky synim e orientoi me sa duket edhe në vijimin e studimeve në Universitetin Ludwig-Maximilian të Munihut (1966/67), si i vetmi institucion universitar, ku përpos fushave të mësipërme ofrohej edhe njohja dhe studimi i shqipes prej docentit të atëhershëm privat Martin Camaj. Në këtë universitet Sasse mbron shkallën e parë të doktoranturës me një “Analizë gjuhësore e të folmes arabe Mhallamiye në provincën Mardin (Turqia Juglindore)” (1970) sikurse edhe shkallën e dytë (habilitacionin) me një studim të njëres prej gjuhëve kushite lindore “Morfonologji e foljes galabe” (1975), që flitet në jug të Etiopisë dhe veri të Kenias. Në vitin 1977 fitoi vendin e një profesure të nivelit C2 për gjuhësi të përgjithshme në po këtë universitet dhe pas vitit 1987 deri në pensionimin e tij (më 2008) drejtoi sektorin e gjuhësisë së përgjithshme si profesor i gjuhësisë së përgjithshme dhe krahasuese në Universitetin e Köln-it (RFGJ).

Karriera akademike dhe lista e gjatë dhe e shumëllojshme e botimeve (shih më poshtë) dëshmojnë sa bindshëm aq edhe mahnitshëm atë spektër të gjerë të angazhimit intelektual-shkencor të Hans-Jürgen Sasse-s, në të cilin pozicion qendror e të përhershëm kanë zënë dashurpa-dashur gjuhët e rrezikuara drejt zhdukjes, një angazhim ky që u nxit me sa duket qysh në të ri të tij gjatë kontaktit me arvanitishten. Të njëjtën situatë përjetojmë në studimin e tij mbi dialektin arab në Turqinë Juglindore, i cili nuk lejohej gjithashtu të përdorej aspak si mjet komunikimi në ambientet publike, meqë edhe në Turqi deri vonë sundonte doktrina, që në hapësirën shtetërore-nacionale turke duhej të përdorej vetëm një gjuhë publike: turqishtja. Një situatë të ngjashme, edhe pse në rrethana kulturore-politike krejt të ndryshme, përcjell puna e tij në terren në vitet 90-të të shekullit të kaluar për dokumentimin e materialit gjuhësor të cayuga-s. Bëhet fjalë për një pinjoll të familjes së gjuhëve irokeze në një zonë kufitare midis SHBA-ve dhe Kanadasë, i cili flitej/t ende ashtu gjysma-gjysma vetëm nga folës të moshuar natyrorë, siç pranohet tashmë edhe zyrtarisht për shumicën e gjuhëve indiane në Amerikën e Veriut.

Njohja në terren e gjuhëve të kësaj natyre e lejoi Hans-Jürgen Sasse-n të depërtojë thellë dhe natyrshëm në vetë jetën e folësve të

tyre natyrorë, si bashkësi e shtresa shoqërore krejt të marginalizuara, të cilave u duhet/j të mbijetojnë edhe ekonomikisht në një mjedis kompleks kulturor-gjuhësor multi-etnik. Këtë rrethanë na e kumton më së miri punimi i tij i habilitacionit që cituam më lart. Nuk është pra aspak rastësi që Hans-Jürgen Sasse ishte bashkëthemeluesi i "Grupit të punës për gjuhët në rrezik" (AGBS - 1992) që mori formë e hodhi shtat më pas si "Shoqata për gjuhët në rrezik" (GBS - 1998), të cilën ai e drejtoi me aq përkushtim deri në vitin 2002.

Asgjëmangut, për rrethet shkencore-intelektuale albanologjike, të cilave këso rasash u mungon informacioni sado minimal në manualët akademikë shqip me karakter enciklopedik (khs. FESH 2008/9), pika e rëndësës anon sigurisht në interesimin ndaj prurjeve të Hans-Jürgen Sasse-s në arvanistikë si njëri ndër pionierët e themelimit të kësaj disipline moderne albanologjike.¹ Bëjmë fjalë këtu për dokumentimin, krehjen dhe klasifikimin mbi baza teorike e me zbatim të një metodike pune të sprovuar të materialit gjuhësor, të mbledhur në mënyrë sistematike në një sërë ekspeditash në terren nëpër ngulimet arvanitase të Greqisë, të cilat janë përfutur kryesisht gjatë emigracionit historik dhe ekspansionit demografik shqiptar drejt jugut të Greqisë dhe ishujve të saj në shek. XIII-XV. Falë këtij dokumentacioni dhe formimit të tij historik-filologjik Hans-Jürgen Sasse ngjiti natyrshëm perspektivat e zhvillimit sociolinguistik të këtyre të folmeve në aksin kohor, duke përcjellë bindshëm mendimin se folësit natyrorë arvanitas përdorën e përdornin brez pas brezi deri në fund të shek. XIX një varietet jugor të shqipes si mjet komunikimi brendapërbrenda bashkësisë, ndërsa në kontakt me fqinjët grekë greqishten. Ky konstelacion sociolinguistik dhe shkëputja disashekullore e lidhjeve natyrore me hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan bëri që në këto enklava të diasporës shqiptare në Greqi të përfutohej një varietet i ri gjuhësor i shqipes, pikërisht arvanitistia, si një gjuhë shqipe me ndikime të fuqishme prej varieteteve përkatëse të greqishtes (së folur) përreth. Sasse syzon kështu hap pas hapi fazat e zhvillimit të dukurisë së dygjuhësisë në ngulimet arvanitase të Greqisë, të cilat në një formë a një tjetër i kanë përshkuar dhe i përshkojnë sot e gjithë ditën shumë gjuhë të rrezikuara drejt shuarjes. Kështu, ai vëzhgon dhe dokumenton fuqizimin e kësaj dukurie në vazhdimësi menjëherë pas përfutimit të formacionit shtetëror nacional grek në gjysmën e parë të shek. XIX. Gjithsesi, deri në fillim të

¹ Pa dashur t'u anashkalojmë këtu aspak prurjeve të pararendësve të kësaj disipline në shek. XIX, sidomos syresh të atij kalibri, si: J. G. von Hahn, C. H. T. Reinhold, J. Fallmerayer, G. Meyer, A. Kupitori, P. A. Furiki etj., lejohemi të përmendim shkurt me këtë rast edhe emrin e albanologut gjerman Claus Haebler, të ballkanologut grek L. Tsitsipis e sidomos atë të filologut të shquar Titos Jochalas në kohën tonë.

shk. XX përgjithësisht në ngulimet arvanitase kjo dukuri ruante ende proporcionet: arvanitishtja si gjuhë e parë kundrejt greqishtes si gjuhë e dytë. Pas kësaj periudhe, sidomos në vitet 20-të, kur në mjedisin social-kulturor greko-arvanit shtohet edhe një komponent i tretë – ngulimet e reja greqishtfolëse si rezultat i marrëveshjes greko-turke për shkëmbimin e popullsisë – përjetojmë proporcione të reja në procesin e dygjuhësisë, pasi greqishtja (*lingua del pane*) fiton përfundimisht në ngulimet arvanitase primatin si gjuhë e parë, ndërkohë që arvanitishtja (*lingua del cuore*) kalon përfundimisht në plan të dytë. Kjo fazë u shoqërua më pas – në një periudhë jo më larg se dy breza – në rrëgjimin tej mase të përdorimit të arvanitishtes sot si mjet komunikimi brenda bashkësisë. Vetë Sasse në ekspeditat e tij në terren e kishte gjithnjë të vështirë të kontaktonte ndonjë informant të brezit të ri që të mund të fliste rrjedhshëm arvanitisht.

Formuluam kështu thukët punën e palodhshme dhe koncepcionin madhor të Hans-Jürgen Sasse-s për realizimin e projektit të tij afatgjatë mbi të folmet arvanitase të Greqisë: një punë e censhme që u sendërtua si e tillë në të gjallë të tij, përpos një numri punimesh të shkurtra (shih më poshtë), vetëm në bleun e parë të këtij projekti: “Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland” (Teil I, Ed. Harrassowitz, Wiesbaden 1991), një vepër që është dhe do të mbetet model në gjuhësinë albanologjike moderne, sidomos sa i përket bazës teorike dhe mënyrës së përshkrimit të sistemit gjuhësor në grupin e të folmeve arvanitase për zonën e Atikës Verilindore.

Ndërkohë, sëmundja vrastare nuk e la, siç e kishte në plan, të përpunonte e të përgatiste për shtyp të paktën edhe një ble të dytë, andaj në tavolinën e tij të punës ka mbetur pas gjase ende hapur “Fjalori i arvanitishtes”, të cilin e mblidhte, e krihte dhe e sistematizonte me aq përkushtim e stimë vite e vite me radhë. Sipas radhës së planifikuar duhej të ishte ky bleu i katërt. Materiali i mbledhur për dy blejtë e tjerë në të cilët do të botoheshin si të tillë: a) skica gramatikore të grupeve të tjera të folmeve arvanitase (bl. II) dhe b) një analizë e mirëfilltë diakronike dhe sociolinguistike e arvanitishtes (bl. III), gjëllin diku në bibliotekën e tij, i papërpunuar prej vetë autorit e ashtu siç dinte ta përpunonte vetëm ai autor. E kjo e shton shumë më shumë brengën e ndarjes prej nesh.

Një njeri gjithmonë i qeshur, babaxhan, që të linte fillimisht të flisje, sa të të blinte mendjen, se përse i kishe ardhur në zyrë; e pastaj shtrohej në bisedë me ty sikur e njihje prej vitesh. E kjo përvojë kolegjiale vetëm e shton edhe më shumë brengën e ndarjes. Ndarje dhe brengë bashkë...

B. D.

**Listë e punimeve të Hans-Jürgend Sasse-s
në fushën e arvanitistikës²**

1971. „Arvanitika-Texte aus Kaparelli (Böotien)“. Në: *Dissertationes Albanicae in honorem Josephi Valentini et Ernesti Koliqi Septuagenariorum*. 141-175. München: Trofenik.
1973. (Reçension) M. Camaj, *La parlata Albanese di Greci*. *Südostforschungen* 32.
1973. (Reçension) N. Gjini, *Fjalor shqip-greqisht*. *Südostforschungen* 32, 492-493.
1977. „How Abstract is Albanian? or: Towards a Realistic Theory of Morphophonemics“. Mimeo. 63 f.
1978. (Reçension) G. L. Bevington, *Albanian Phonology*. *Zeitschrift für Balkanologie* 14, 230-238.
1982. „Ein archaischer albanischer Dialekt auf der Insel Andros“. *Zeitschrift für Balkanologie* 18, 61-69.
1982. „Das Verbalsystem der arvanitischen Mundart von Vurkoti (Andros)“. Në: *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia. Atti del IX. Congresso Internazionale die Studi Albanesi – Palermo, 25-28 Novembre 1981, a cura di A. Guzzetta*. 335-358. Istituto di lingua e di letteratura albanese, Palermo: Università di Palermo.
1985. „Sprachkontakt und Sprachwandel: Die Gräzisierung der albanischen Mundarten Griechenlands“. *Papiere zur Linguistik* 32, 37-95.
1987. (Reçension) Titos Jochalas, *Stoicheía elleno-albanikés grammatikés kai ellenoalbanikoí diálogoi. Anékdoto ergo tou Ioanne Belará. Philologike ekdose apó ton autógrapho kódiaka tes Ethnikés Bibliothékes ton Parisión*. *Südost-Forschungen* 45, 502-507.
1990. „Theory of Language Death“ und „Language Decay and Contact-Induced Change: Similarities and Differences“. *Arbeitspapier des Instituts für Sprachwissenschaft Nr. 12 NF*. Köln: Institut für Sprachwissenschaft.
1991. *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Teil I*. Wiesbaden: Harrassowitz. xiii + 547 S.
1991. & W. Breu: „Das sprachwissenschaftliche Werk Martin Camajs (Camaj's linguistic work)“. *Albanica* 2, 23-33.
1991. „Zur Situation der Erforschung des Arvanitischen.“ Në: *Aspekte der Albanologie*, hrsg. v. W. Breu, R. Ködderitzsch und

² Lista e plotë e punimeve mund të konsultohet nëpërmjet internetit <http://ifl.phil-fak.uni-koeln.de/sites/linguistik/asw/pdf/Schriftenverzeichnis_Sasse.pdf>

- H.-J. Sasse (= *Balkanologische Veröffentlichungen*, 18). 61-70. Wiesbaden: Harrassowitz. Auch abgedruckt in: *DARDANIA* 8 (1999), 213-223.
1991. (Botues bashkë me W. Breu dhe R. Ködderitzsch) Aspekte der Albanologie. Akten des Kongresses „Stand und Aufgaben der Albanologie heute“, 3.-5. Oktober 1988, Köln. (=Balkanologische Veröffentlichungen, 18). Wiesbaden: Harrassowitz.
1992. „Die arvanitischen Mundarten Griechenlands“. Në: *Albanica* 3-4. 96-108. Washington, DC: Archi Pipa.
1992. „Zum Ausdruck von Referentialität und Nichtreferentialität im Arvanitischen“. In: Beiträge zur sprachlichen, literarischen und kulturellen Vielfalt in den Philologien. Festschrift für Rupprecht Rohr zum 70. Geburtstag, hrsg. v. G. Birken-Silverman und G. Rössler. 179-191. Stuttgart: Franz Steiner Verlag.
1998. „Arvanitika: The Long Hellenic Centuries of an Albanian Variety“. *International Journal of the Sociology of Language. Small Languages and Small Language Communities* 26, 39-68.
2008. & W. Breu: „Vepra shkëncore e Martin Camajt në fushën e gjuhësisë“. *Hylli i Dritës* 28/3, 84-98.
2010. & W. Breu „Das sprachwissenschaftliche Werk Martin Camajs“. Në: *Wir sind die Deinen: Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, hrsg. v. B. Demiraj (= *Albanische Forschungen*, 29). 13-23. Wiesbaden: Harrassowitz.

Përgatiti Besim Kabashi